REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:290738

Datë: 18.05.2022

Numri i dokumentit: 03028090

C.nr.2913/21

GYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja, Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridiko civile të paditësve: A.K etj, të gjithë nga fshati V., Komuna e P, të cilët i përfaqëson i autorizuari S.M, avokat në P., kundër të paditurit B. Th.. nga fshati B., Komuna e P., të cilin e përfaqëson i autorizuari F.K, nga P., për shkak të vërtetimit të drejtës së pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me dt.16.05.2022, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, merr dhe shpall këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË PRANIMIT

VËRTETOHET se paditësit: A.K etij, të gjithë nga fshati V., Komuna e P., janë bashkëpronarë të ngastrës kadastrale me nr... në sip. prej 29949m² me kulturë mal, ZK B., ashtu që paditësi T.K., është pronar i pjesës prej 4/5 në sip. prej 11979m², ndërsa paditësve të tjerë: A., F., H., Z. dhe N., ju takon nga 1/5 e ngastrës së cekur e në sip. të përgjithshme prej 2995m² të kësaj ngastre.

DETYROHET i padituri B. Th.. nga fshati B., Komuna e P., që paditësve t'iu njohë të drejtën e bashkëpronësisë në patundshmërinë e cekur si në pjesën I të këtij dispozitivi, dhe të lejojë që e njëjta të regjistrohet në regjistrin e paluajtshmërive, pranë Zyrës Komunale Kadastrale, në P., në emër të paditësve në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimi.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit, me padi dhe precizimin e saj të bërë në seancë, dhe gjatë shqyrtimit kryesor, e nëpërmes të autorizuarit të tyre, kanë parashtruar se paditësit janë trashëgimtarë të pronës lëndore pas vdekjes së tani të ndjerit A. K., se pasuria lëndore evidentohet në emrin e paraardhësit të të padituri.

Gjatë shqyrtimit kryesor kanë ritheksuar se paditësit janë trashëgimtarë nga radha e parë e trashëgimisë, pas vdekjes së tani të ndjerit A. K.,-kryefamiljarit të tyre, dhe në emrin e tij evidentohet e tërë prona e familjes.

Kanë sqaruar se babai i paditësve shumë kohë më parë, e ka blerë patundshmërinë lëndore, nga O. dhe S. J., dhe atë sipas paditësve në vitin 2008, dhe ka hyrë në posedim të qetë dhe faktikë të malit deri me sot. Në ndërkohë babai i paditësve ka vdekur, dhe nuk e ka bartur në emrin e tij, për shkak të shumë pengesave teknike, si shëndetësore dhe financiare.

Se edhe i padituri B., nga po të njëjtit shitës, e kishte blerë gjysmën e malit me numër të ngastrës ..-.., dhe ai ka vazhduar me procedurën e mbartjes menjëherë, dhe gabimisht e ka përkthyer edhe pjesën-gjysmën e malit, që tani më e kishte blerë i ndjeri A. K., këtë gabim e kanë vërejtur të dyja palët, dhe janë pajtuar që ta zgjedhin me marrëveshje. Ka theksuar se në

2021:290739

teren veç ekziston ndarja faktike, mirëpo me padi e kërkojnë 1/2 të ngastrës së cekur, sepse nuk kanë asnjë problem me palën e paditur, dhe do të vazhdojnë me ndarjen fizike, me ekspert gjeodet ku fillimisht do të bëjnë matjen dhe të caktojnë megjat, dhe menjëherë para gjykatës do ta përmbyllim këtë çështje menjëherë.

I autorizuari i të padituri në përgjigje në padi të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor e pas matjeve të bëra me pëlqimin e të autorizuarve të palëve ndergjyqëse, ka deklaruar se nuk e konteston padinë dhe kërkesën e saj të precizuar, e as thëniet e të autorizuarit të paditësve gjatë shqyrtimin kryesor, në veçanti ka potencuar se ka autorizim që paditësve t'ju aprovoi kërkesëpadinë e precizuar si të bazuar, duke përsëritur se i padituri e gëzon legjitimitetin pasiv, për këtë i ka propozuar gjykatës, që kërkesë padinë e paditësve, ta aprovoj në tërësi si të bazuar, dhe të bie aktgjykim në bazë të pohimit pa i administruar provat.

Pasi që i padituri nëpërmes të autorizuarit të tij e ka pranuar në tërësi kërkesë padinë, atëherë gjykata pa shqyrtim të mëtejmë merr aktgjykim në bazë të pohimit, në kuptim të nenit 148 të LPK, dhe vendosi si më lartë.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË,C.nr.2913/21, me dt.16.05.2022.

Gj y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

KËSHILLA JURIDIKE:
Meqë palët kanë hekur dorë nga ankesa,
aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm në ditën e marrjes.